



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28 e datës 4 qershor 2008, si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës merr:

VENDIM

PËR THEMELIMIN E EKIPIT KOMUNAL PËR ZBATIMIN DHE MONITORIMIN E HARTËS ZONALE TË KOMUNËS

Neni 1

Përbërja

Themelohet, Ekipi komunal për zbatimin dhe monitorimin e Hartës Zonale të Komunës-HZK, në përbërje si vijon:

1. Hasim Vishesella , DPUMM, Koordinator i EKZM
2. Brahim Duriqi, Drejtorati për Arsim, anëtar
3. Shehide Sopa, Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim , anëtare
4. Afrim Sadiku, Drejtorati për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, anëtar
5. Albert Mustafa, Drejtorati për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, anëtar
6. Bekim Zaskoku, Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport, anëtar
7. Fatbardha Shurdhiqi, Drejtorati për Infrastrukturë, anëtare

Neni 2

Detyrat dhe përgjegjësitë e Ekipit komunal (EKZM)

Ekipi komunal për zbatimin dhe monitorimin e Hartës Zonale të Komunës do ti kryej detyrat dhe përgjegjësitë në pajtim me dispozitat për zbatimin hartës zonale të Komunës dhe përgjithësisht kryen punët si vijon:

Koordinatori i EKZM zgjidhet për 12 muaj, pastaj viteve në vijim koordinatori zgjidhet me rotacion poashtu për 12 muaj nga anëtarët e drejtorive sektoriale pjesë e EKZM .

Koordinatori i EKZM kryen rolin e sekretariatit, duke mbledh dokumentacionin e nevojshëm nga drejtoritë dhe institucionet tjera, përgatitjen e takimeve te rregullta, përcakton personin për mbajtjen e minutave nga takimet, shpërndan ftesat dhe dokumentacioni e mbledhur, dhe çdo detyre tjetër që mund të rrjedh ne qellim të mbarëvajtjes se punës se EKZM.

Me qellim të zbatimit të HZK-se, EKZM ka për detyrë të përpiloj planet vjetore sektoriale, të cilat janë ne harmoni me kërkesat për zbatim të HZK-se, për secilën drejtori komunale. Këto plane sektorale finalizohen dhe shpërndahen tek të gjitha drejtoritë ne afat kohor të

mjaftueshëm qe siguron integrimin e tyre ne planin financiar komunal final qe trajtohet nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa, me qellim te përfshirjes ne buxhetin e ardhshëm komunal.

Neni 3
Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe me të njëjtin të njoftohen Koordinatori dhe anëtarët e tjerë të ekipit komunal.

Nr. 01-350/01-17172
Lipjan, më 01.01.2022



Imri AHMETI

Kryetar i Komunës